



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:267831  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05471251

**C.nr.4625/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm**, Divizioni civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditëses: paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S.D. me numër personal ..... nga Prizreni, me objekt kontesti: kompensim dëmi, vlera e kontestit 374.41 €, jashtë seance, më datë 19.03.2024, mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

**Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia**

**REFUZOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, *me të cilin ka kërkuar që të “ Aprovohet kërkesë padia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A, në tërësi si e bazuar obligohet i padituri S. (A) D. që paditësit të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 374.41 € dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti- të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënim të përmbarimit”*. **si e pabazuar**.

**A r s y e t i m**

Paditësja, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë - me datën 05.12.2023, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit S.D. nga Prizreni, duke theksuar se me aktgjykimin penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.760/21 të datës 20.10.2021 i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 314 ë KPRK, e dëmtuara është udhëzuar në kontest civil. Me veprimet e tij i padituri, i ka shkaktuar dëm material paditëses në vlerë prej 374.41 €.

Gjykata me aktvendimin C.nr.4625/2023 të datës 01.03.2024 ka ftuar paditësen për pagesën e taksës gjyqësore.

Paditësja me parashtrësën e datës 15.03.2024 e njofton gjykatën se i padituri ka përmbushur detyrimin për të cilën është paraqitur padia ndaj paditëses dhe mbi këtë bazë tërhiqet nga padia dhe kërkesëpadia. Njëherit parashtrësës i ka bashkangjitur: ekstraktin nga libri afarist të konsumatorit me shifër DPZ 145083.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se “*Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës*”, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se “*Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre*”.

Gjykata shprehjen e përdorur nga paditësja tërheqje nga padia dhe kërkesëpadia, ka trajtuar si heqje dorë nga kërkesëpadia pasi që me ligjin e procedurës kontestimore, paditësi mund të heq dorë nga kërkesëpadia, por jo të tërhiqet nga kërkesëpadia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)*” – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.4625/2023, datë 19.03.2024**

**G j y q t a r i**

**Taulant Rexhëbeqaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak i heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.